

VENDIM
Nr. 65, datë 7.4.2025

**MBI ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s PËR SHQYRTIMIN
E KËRKESËS SË SHOQËRISË “GREEN ENERGY” SHPK, PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, ME KAPACITET
PRODHUES 2 mw**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.4.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1172/7 prot., datë 4.4.2025, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Green Energy’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”, si dhe informacionin shtesë me nr. 1172/9 prot., datë 7.4.2025, “Në vijim të relacionit nr. 1172/22 prot., datë 6.11.2024, ‘Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Green Energy’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike””, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes,

konstatoi se:

- Për qëllime të shqyrtimit të këtij aplikimi janë ndjekur procedurat dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Paraqitja e kërkesës për licencim

- Shoqëria “Green Energy” sh.p.k., më datë 20.2.2025, dorëzoi në ERE kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

2. Fillimi i procedurës së licencimit

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 53, datë 3.3.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- Në datat 4.3.2025 dhe 5.3.2025, ERE publikoi njoftimin për fillimin e procedurës në median e shkruar dhe në faqen zyrtare të internetit.

- Deri më datë 13.3.2025, datë kur përfundoi afati për paraqitjen e komenteve apo objeksioneve nga të tretët, nuk rezultoi të ketë të tilla.

3. Kërkesa për dokumentacionin plotësues

- Me shkresën nr. 1172/4 prot., datë 6.3.2025, ERE njoftoi shoqërinë për vendimin nr. 53/2025, si dhe për zhvillimin e një seance dëgjimore në ambientet e ERE-s, me qëllim sqarimin e dokumentacionit të munguar.

- Me shkresën nr. 1172/5 prot., datë 6.3.2025, ERE njoftoi Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e procedurës, si dhe për zhvillimin e seancës dëgjimore në ERE, me qëllim marrjen e sqarimit/qëndrimit përkatës të MIE-s, në lidhje zbatimin e detyrimeve të shoqërisë për sa i përket afateve të ndërtimit/vënies në punë të centralit dhe/ose të vlefshmërisë së kontratës.

4. Vlerësimi i dokumentacionit dhe kërkesa për seancë dëgjimore

- Në seancën dëgjimore të zhvilluar në ERE, më datë 13.3.2025, u paraqit vetëm përfaqësuesi i shoqërisë “Green Energy” sh.p.k. dhe nuk u paraqitën përfaqësues të MIE-s. Pas diskutimeve në seancë, shoqërisë iu sqarua dokumentacioni i munguar apo i plotësuar pjesërisht, për të cilin është njoftuar dhe me shkresën nr. 1172/4 prot., datë 6.3.2025, si dhe nga ana e përfaqësuesit të shoqërisë u mor angazhimi për të depozituar sa kërkuar nga ERE. Për sa trajtuar dhe lënë detyrë, dhe në seancën dëgjimore shoqërisë iu dërgua *email*-i më datë 26.3.2025, protokolluar në ERE me nr. 1172/6 prot.

- Shoqëria, me *email*-in e datës 7.4.2025, ka parashtruar si vijon: “*në vijim të seancës dëgjimore pranë ERE-s për aplikimin e realizuar nga shoqëria “Green Energy” sh.p.k., ju bëjmë me dije se jemi në fazë të mbledhjes së dokumentacionit të kërkuar nga ana juaj të cilat do t’i dorëzojmë pranë protokollit në ditët në vijim.*”.

5. Shtyrja e afatit të vendimmarrjes

- Referuar nenit 14, pika 3, të rregullores, Bordi i ERE-s mund të zgjatë afatin e vendimmarrjes deri në 30 ditë, kur dokumentacioni nuk është i plotë.

- Për sa më lart dhe për t'i dhënë mundësinë shoqërisë që të depozitojë në ERE informacionin dhe dokumentacionin e munguar të aplikimit, vlerësohet zgjatja deri në 30 (tridhjetë) ditë e vendimmarrjes së Bordit, në lidhje me aplikimin e saj. Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin e munguar brenda 20 (njëzet) ditëve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “Green Energy” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin e munguar brenda 20 (njëzet) ditëve.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti